



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**  
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

---

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P. nr.130/19**

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICËS-departamenti i përgjithshëm,** gjyqtari i vetëm gjykues Gezim Ademi, dhe procesmbajtësja Hasnije Muhaxheri, ne lenden penale ndaj te pandehurit H.M me vendbanim ne Rr. “...” nr. ... ne ... për shkak te veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 ne lidhur me par 1 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës te Prokurorisë Themelore ne Mitrovice-PP.II.nr.98/19 te datës 01.02.2019 pas mbajtjes se shqyrtimit gjyqesor te dt. 24.06.2019, ne mungese te prokurorit e ne prezence te pandehurit me datën 25.06.2019, e beri shpalljen, ndërsa me datë 28.06.2019, merre këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri: H.M , nga i ati R., e ëma M., e vajzërisë M., i lindur me ... me vendbanim ne ..., me nr. Personal ..., ka kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes se dobët ekonomike, Boshnjak , Shtetas i Republikës se Kosovës.**

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** Me datën 28.12.2018 rreth orës 19:00, ne ... ne rrugën ‘...’ nr ..., ka shkaktuar lëndime te lehta trupore bashkëshortes se tij S.M, me këtë mënyrë pas përleshjes me te dëmtuarën, se fëmija e mitur është lazdruar dhe ai i ka bërtitur bashkëshortes qe te qetëson fëmijën dhe atëherë e ka goditur me dore ne fytyrë dhe ne pjesën e trupit dhe i ka pësuar lëndime te lehta trupore e te cilat janë te karakterit te përkohshëm për shëndet.

Me këtë ka kryer veprën penale- **Lëndime te lehta trupore nga neni 188 par 3 pika 3.1 te KPRK-ës**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,21,41,49,50,51,52,73, dhe 188 par 3 pika 3.1 te KPRK-ës dhe nenit 365, 450,463 te KPP-ës e:

## **G J Y K O N**

**ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJE PREJ gjashte 6 muaj**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale ne kohëzgjatjeje prej 1 (një) vite.

**OBLIGOHET** i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale- paushallin gjyqësor te paguaj shumen prej 20 euro, ne emër te ekspertizës mjeko-ligjore shumen prej 20 euro, për fondin e kompensimit te viktimave te krimit shumen prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike-kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

**Prokuroria Themelore ne Mitrovicë** - ka ngritur aktakuze PP.II.nr. 98/2019 te datës 01.02.2019, kundër të pandehurit H.M nga Mitrovica, për shkak te veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 ne lidhur me par 1 pika te KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me dt. 24.06.2019 ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: se e ndjej veten fajtor per veprën penale qe me vihet ne barrë, dhe i premtoj gjykatës se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra penale ,dhe njëherit me vjen keq për rastin qe ka ndodhur, ne kemi fëmijë, ne jetojmë bashkë, ne kemi raporte te mira dhe qe nga atëherë nuk kemi pasur problem. Po ashtu i pandehuri ne fjalën përfundimtare i propozon gjykatës qe te me shqipton një dënim sa me te bute nga se qe nga ky rast nuk kemi pas kurrfarë problemi ne mes veti.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: se pranimi i fajësisë ishte i vullnetshëm pa presion dhe se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 par 2 dhe se gjykata me rastin e shqiptimit te dënimit gjykata pranimin e fajësisë ta merr si rrethane lehtësues, po ashtu gjykata ta ketë parasysh se te njëjtit janë pajtuar dhe kane raporte te mira bashkëshortore dhe se qe nga ajo dite nuk kane pasur ma probleme ne mes veti te gjitha këto gjykata ti merr si rrethane lehtësues me rastin e shqiptimit te dënimit. Ne fjalën përfundimtare prokurori i shtetit mbetet ne tersi pranë aktakuzës, nga se sipas provave qe gjendet ne shkresat e lendes si dhe nga vet pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit konsiderohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale për te cilën ngarkohet, i propozoj gjykatës qe te njëjtin ta shpalle fajtor ta dënoj sipas ligjit dhe ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rëndesë.

E dëmtuara lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: i propozoj gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe kërkojë nga gjykata që të njëjtin ta liroj nga dënimi nga se kemi raporte të mira dhe jemi mbajtës të fëmijëve dhe se kanë nevojë që të kujdesem për ta. Në fjalën përfundimtare i propozon gjykatës që ta liroj nga dënimi ngase kemi raporte të mira dhe se që nga ajo kohë ma nuk kemi pas probleme.

### **Vlerësimi i pranimit të fajësisë.**

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte në përputhje me neni 248 pasi që i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bënë në mënyrë vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje të qarte ligjore apo gabime faktike që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, të gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë në përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës si: Raporti i mjekut Mitrovicë nr. ... nga dt. 28.12.2018, disa fotografi, certifikata e evidencës penale në emër të pandehurit nga Janari 2019 dhe gjetjet e mendimit të ekspertit-mjeko ligjor nga Prishtina nga dt. 12.01.2019 si dhe shkresat tjera që gjenden në lende, nga të gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 në lidhur me par. 1 të KPRK-së

### **Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.**

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e dënueshme me dënim me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykate si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale. Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e që nga deklarimi i tij me rastin e pranimit të fajësisë i njëjti deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tillë i të pandehurit për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tij për veprën penale. Si rrethanë tjetër lehtësuese ka marrë edhe raportet e mira në mesë familjeve.

Nga të gjitha këto gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit pasi që për gjykatën në rrethana të tilla mjafton se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimeve, do të ndalojë kryerësin që të mos kryej vepra penale në të ardhmen e që ky është edhe qëllimi i dënimit me kusht. Nga të gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit.

**Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.**

Lidhur me shpenzimet procedurale- ekspertizën mjeko-ligjore shumen prej 20(njëzet)euro për paushallin gjyqësor te paguaj shumen prej 20(njëzet) Euro, ndërsa për fondin e kompensimit te viktimave te krimin shumen prej 30(tridhjetë)euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

**Lidhur me kërkesën pasurore juridike.**

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450, te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P. nr.130/2019 dt.28.06.2019**

Procesmbajtësja :  
**Hasnije Muhaxheri**

Gjyqtari:  
**Gëzim Ademi**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate